



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 4

Prishtinë, më 6.11.2017, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë : Daut Haradinaj, Besa Gaxherri, Driton Çaushi, Ganimete Musliu, Lutfi Zharku, Enver Hoti, Danush Ademi, Andin Hoti, Srdjan Mitrovic, Salih Salihu.

Mungoi : Liburn Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë : sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Daut Haradinaj**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 30.10.2017,
3. Shqyrtimi i draft planit të punës së komisionit për vitin 2017,
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.10.2017

Kryetari i Komisionit konstatoi miratimin e komisionit për procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

3. Shqyrtimi i planit të punës së komisionit për vitin 2017

Kryetari Daut Haradinaj përshëndeti anëtarët e komisionit dhe i ftoi për sugjerime apo plotësime që eventualisht kanë për planin e punës për këtë vit i cili edhe pse është në përfundim e sipër megjithatë mund të sugjerohen çështjet prioritare apo monitorime të ligjeve që janë të rëndësishme së veçantë apo urgjente, në mënyrë që komisioni në mbledhjen e sotme të miratoi grupet punuese të cilat pastaj bashkërendisin prioritetet që do të mbikëqyren. Pasi që nuk është prezent Liburni, vazhdoi, për të saktësuar se çka do të ishte prioritet për mbikëqyrje, ai supozoi se nga diskutimet e tij në mbledhjen e fundit fokusi duhet të jetë tek ndërtimet, çka vërtetoi edhe deputeti **Driton Çausi** të cilit ia ka përcjell porosinë personalisht deputeti z. Aliu. Sa i përket fushës së bujqësisë u fokusuan problemet gjithashtu aktuale si p.sh. AUV dhe çështjet doganore me ushqimin, kurse **Enver Hoti** potencoi Ligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural i cili ligj megjithatë përfshin çështjet kyçe në bujqësinë tonë, ndaj komisioni këtë pikë të rendit të ditës përfundoi duke nxjerr këtë :

P Ë R F U N D I M

1. **GRUPI PUNUES** për mbikëqyrjen e Ligjit për Ndërtimin e përbëjnë : **Liburn Aliu-kryesues, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Enver Hoti, Danush Ademi dhe Srdjan Mitrovic**. Ky grup punues fillimisht do të mban takimin konsultativ të cilin do ta caktoj kryesuesi.
2. **GRUPI PUNUES** për mbikëqyrjen e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural e përbëjnë : **Andin Hoti-kryesues, Srdjan Mitrovic, Salih Salihu, Driton Çausi, Ganimete Musliu, Enver Hoti dhe Danush Ademi**.
3. **MIRATOHET** plani i punës së Komisionit për vitin 2017 me plotësime.

4. Të ndryshme

Në pikën të ndryshme Kryetari njoftoi se aktivitetet e komisionit do të vazhdojnë me takime të ndryshme me bashkëpunëtorë të ndryshëm, ndërkaq për takimin e radhës komisioni do të njoftohet me kohë .

Mbledhja përfundoi në orën 12,45.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Daut Haradinaj